



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2314/4 Prot.

Vlorë më, 28.08. 2026

VENDIM

Nr. 50, datë 28.08.2026

**PËR MIRATIMIN E SHTOJCËS FINANCIARE ME KOMPANINË "NSED.IO" PËR
REKRUTIMIN E STUDENTËVE NDËRKOMBËTARË**

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Ligjit nr. 9936, datë 02.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; të nenit 25, pika 1, gërma "q", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 14 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 6, pika 3, gërma "c", të Rregullores Financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të propozimit të Administratorit të UV-së, përcjellë me shkresën nr. 1727/3 prot., datë 25.08.2026; Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 28.08.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Shtojcën Financiare të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe kompanisë NSED.io**, e cila përcakton kushtet financiare për shërbimet e promovimit dhe rekrutimit të studentëve ndërkombëtarë.
2. Pagesat në zbatim të këtij vendimi të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe procedurat financiare të Universitetit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është **Shtojca Financiare me kompaninë NSED.io**, e cila përcakton kushtet financiare të bashkëpunimit
4. Ngarkohet Administratori dhe Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj


Elmira Kushta

Ledina Mançka

Orkida Hasani

KRYETAR
Saniela XHAFFERI

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288



web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al